

# Nacionale

REDAKTOR: Valon A. Sylva  
E-MAIL: valon.sylva@gazetaexpress.com  
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2

## Gjermanët ndihmojnë 700 nxënës

**SHARR, 18 SHTATOR** — Me investimin e Zyrës ndërlidhëse me popullatën civile (CIMIC) të KFOR-it gjerman dhe Kuvendit Komunal të Sharrit, rreth 700 filloristë të fshatrave Buqe, Pllavë dhe Brezno, do t'i ndjekin mësimet në kushte shumë më të mira, pasi që është përfunduar objekti i

renovuar i Shkollës Fillore "Shaban Shabani", në Llopushnik të Opojës. Komandanti i Task Forcës së Jugut, gjenerali Lutz Niemann, shprehu kënaqësinë e tij, për faktin se me rinovimin e kësaj godine shkollë, janë krijuar kushte shumë më të mira për shkollimin e fëmijëve të kësaj

treve, duke premtuar se edhe në të ardhmen KFOR-i gjerman do të përqendrohet në përmirësimin e infrastrukturës së kësaj komune shumëtnike. Për realizimin e këtij projekti, CIMIC-i gjerman ka investuar mbi 32 mijë euro, ndërkaq nga buxheti i komunës janë investuar 10 mijë euro.

# NE MES GLOBALIZ

**Miti se diaspora e mban të gjallë Kosovën i takon të kaluarës. Bashkimi Evropian po ndjek politika kundërtë në raport me Kosovën dhe diasporën. Qeveria e jonë nuk ka lidhje se çka po ndodh në terren. Një pasqyrë tepër të errët për ekonominë e Kosovës e japin ekspertët e Institutit Evropian për Stabilitetin. Sipas tyre, vendi ynë po shkon, pashmangshëm, drejt një revolte qytetare.**



Çka do të punojë kur të rritet. / FOTO: ERMAL META

### ESI

Nëse ekziston një dëshmi universale për gjithë Kosovën e pasluftës, atëherë ajo është që paratë e dërguara nga diaspora mbajnë në këmbë ekonominë e këtij vendi. Hartuesit e strategjive ndihen komfort kur bëjnë llogaritë të ndryshme për diasporën, sidomos atëherë kur llogarisin në zemërgjerësinë e tyre duke besuar se do të vazhdojë edhe në të ardhmen e njëjta gjendje. Paratë e dërguara, jo vetëm që mbushin hapësirat financiare, por edhe krijojnë një siguri joformale sociale, sidomos për kryeshtëpiakët e varfër.

“ESI vlerëson se është absurde të investosh qindra miliona euro për stabilizimin e Kosovës, dhe në anën tjetër të mbyllësh derën për emigrantët e kësaj ane. Nëse Evropa mendon seriozisht që të gjejë një zgjidhje afatgjate politike dhe stabile për Kosovën, atëherë, patjetër, duhet të identifikojë mënyrat se si kosovarët ruralë të gjejnë punë përkohësisht jashtë vendit. Alternativë tjetër e vetme do të ishte dërgimi i më shumë policëve në Kosovë, të cilët do të merreshin me gjeneratat e reja, të hidhëruara dhe të dëshpëruara nga gjendja e veshtirë ekonomike.”

Raporti i ESI-t përmban një porosi jo të mirë për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Raporti i ri i Iniciativës për Stabilitetin Evropian (ESI), raporton se kohët në Kosovë kanë ndërru-

ar. Paratë e dërguara nga imigrantët janë në rënie të madhe, për shkak se ato financuan rindërtimin e të gjitha shtëpive të rrënuara nga lufta. Prej intervenimit të NATO-s në vitin 1999

emigrimi ka marrë kahje të kundërt. Dikur kosovarët shkonin për Gjermani, përderisa tash janë të obliguar të kthehen nga atje. Rreth 100 mijë kosovarë janë kthyer vetëm nga Gjermania,

përderisa ky vend e mban për derën e mbyllur për tjerët që dëshirojnë të shkojnë atje. Migrimi në Kosovë pothuajse është mbyllur. Janë shumë më fat ato familje kosovare që kanë edhe

## Agrokultura ndërpre në grevën

Të tridhjetë punëtorët e ndërmarrjes "Agrokultura", të cilët një muaj pasi kishin filluar grevën, të pakënaqur me largimin e tyre nga vendet e punës nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), kanë ndërprerë grevën, konfirmuan të hënën anëtarë të Këshillit Grevist. Ata thanë se vendimin për ndërprerjen e grevës, e ka marrë

Këshilli Grevist, sindikata dhe punëtorët, por nuk kanë komentuar asgjë më shumë rreth plotësisht të kërkesave të tyre. Tridhjetë punëtorët e ndërmarrjes shoqërore "Agrokultura" në Gjilan, patën filluar grevën më 16 gusht, pas pushimit të tyre nga puna. Punëtorët e larguar nga puna pretendojnë se ndërmarrja e tyre

është privatizuar vetëm 30 për qind. Ruzhdi Selimi e Skender Haliti, anëtarë të Këshillit Grevist, thanë të hënën se vendimin për ndërprerjen e grevës e ka marrë Këshilli Grevist, grevistët dhe kryesia e sindikatës, për shkak të emërimit të Bordit të ri menaxhues, që ka qenë njëra nga kërkesat. Gjatë grevës së tyre njëmuajore, grevistët nuk i

kanë lejuar hyrjen në objekt menaxherit të tyre, sikur që janë takuar me zyrtarë komunal, sindikalistë, përfaqësues të AKM-së, si dhe janë vizituar nga Ombudspersoni i Kosovës. Anëtarët e Këshillit Grevist nuk kanë pranuar të flasin më shumë rreth ndërprerjes së grevës, e as nëse punëtorët kanë realizuar ose jo kërkesat e tyre.

# ZIMIT DHE ODAVE

më tutje anëtarë të tyre jashtë vendit. Kjo është, faktikisht, edhe shtresa e vetme e kosovarëve që mund të migrojnë në Perëndim. Sipas raportit të ESI-t, rreth 15 për qind të familjeve kosovare pranojnë rregullisht të ardhura nga emigrantët. Kjo, në fakt, i ka mbajtur gjallë pjesët rurale të Kosovës. Kjo traditë e dërgimit të parave gradualisht po zvogëlohet.

Ky, sipas ESI-t, është një lajm i keq për shtetet e BE-së. Kjo organizatë vlerëson se është absurde të investosh qindra miliona euro për stabilizimin e Kosovës, dhe në anën tjetër të mbyllësh derën për emigrantët e kësaj ane.

Refuzimi i refugjatëve është edhe më i vështirë kur bëhet fjalë se dera po i mbyllet një shoqërie të vogël – rreth dy milionë banorësh, në kohën kur miliona rumunë, bullgarë, polakë janë duke gjetur punë përmes emigrimit në shtetet e BE-së.

Nëse Evropa mendon seriozisht që të gjejë një zgjidhje afatgjate politike dhe stabile për Kosovën, atëherë, patjetër, duhet të identifikojë mënyrat se si kosovarët ruralë të gjejnë punë përkohësisht jashtë vendit.

Alternativë tjetër e vetme do të ishte dërgimi i më shumë policëve në Kosovë, të cilët do të merreshin me gjeneratat e reja, të hidhëruara dhe të dëshpëruara nga çdo gjë. Raporti i ESI-t, gjithashtu, përmban një mesazh negativ edhe për bërësit e strategjive në Kosovë. Migrimi dhe paratë e dërguara nga emigrantët e kanë ndihmuar jetën, por nuk kanë ndikuar në zhvillimin e vendit. Përkundrazi, paratë e dërguara kanë ndikuar në konservimin e shoqërisë më të vjetër evropiane, institucionin më konservativ – që është kryefamiljari patriarkal tradicional.

Shumica dërmuese e familjeve fshatare në Kosovë i kanë shpëtuar socializmit për 50 vjet, duke u munduar që të mbrohen nga institucionet armiqësore shtetërore. Kjo, gjithashtu, ka ndikuar në ndaljen e zhvillimit rural dhe ka kontribuar në mosinvestim në arsim dhe iniciativa ndërmarrëse. Mungesa e edukim-



FOTO: ERMAL META

“Më e keqja është atëherë kur autoriteti patriarkal në familje do të dobësohet, shoqëria rurale mund të fillojë të humbë dëgjueshmërinë tradicionale ndaj kryefamiliarit dhe pakënaqësitë në familje të fillojnë t'i shfaq në publik. E gjithë kjo ka ndodhur më herët në disa vende të Evropës Lindore.”

it dhe ndërmarrësisë më pas ka ndikuar te femrat kosovare të cilat, kryesisht, janë të papunësuara, duke mbajtur nivelin më të ultë të edukimit në Evropë. Kjo situatë e vuri Kosovën rurale në varësi nga paratë e dërguara për të shpëtuar nga kurthia e ligë e mosprospërimitit.

E gjithë kjo situatë mund të ndikojë në të ardhmen që kryefamiljari tradicional të izolohet nga tërësia shoqërore – ashtu siç ka ndodhur nganjëherë gjatë historisë nëpër Ballkan. Pasoja për shoqërimë rurale do të ishin shumë serioze. Sidomos atëherë kur solidariteti tradicional do të humbasë, atëherë kjo do të çonte në një eskalim dhe cenim serioz nga vrazhdësia që do të krijohet.

Çka është më e keqja, atëherë autoriteti patriarkal në familje do të dobësohet, shoqëria rurale mund të fillojë të humbë dëgjueshmërinë tradicionale dhe

pakënaqësitë në familje të fillojnë të shfaqen në publik. E gjithë kjo kishte ndodhur më herët në disa vende të Evropës Lindore. Shteti i Kosovës nuk guxon të qëndrojë pasiv ndaj pjesëve rurale. Është më se e nevojshme të identifikohen politikat dhe strategjitë, më pas institucionet dhe resurset t'i përgjigjen krizës sociale në rritje në fshatra. E kundërta, projekti për shtetformimin e Kosovës do të dështojë. Nëse shteti nuk do të jetë i aftë të reagojë më kohë do ta gjejë vetën në një rend të ri dite të diktuara nga gjeneratat e reja të hidhëruara.

### BE në kundërshtim me vetën

Dilema themelore për Kosovën rurale nuk është e re. Në vitin 1979 Banka Botërore në një raport mbi varfërinë në Jugosllavi shkruante se "varfëria në këtë vend është kryesisht rurale". Për këtë vend ky raport mbante shpresë për zhvil-

lim dhe rritje të punësimit, përdërisa i vetmi vend që nuk kishte shpresë për ndryshim ishte Kosova.

"Përfundim është Kosova, e cila nuk mundet të shpëtojë as në përmbledhjet me optimiste, e as kur arrihet të përmbushen planet e parapara për zhvillim, për shkak se nuk mund t'i shpëtojë rritjes rapide të forcës punëtore".

Prej kësaj kohe, popullata e Kosovës ka filluar të rritet shpejtë por numri i vendeve të punës dhe mundësive të punës në bujqësi nuk ka mundur ta kapë dinamiken. Pa planifikime reale për punësim brenda Kosovës, duke ia shtuar këtu mosmbështetjen institucionale nga shteti gjenerata të tëra të kosovarëve filluan të migrojnë drejt Gjermanisë dhe Zvicrës – shpesh duke qenë kjo mundësia e vetme për shpëtim. Sipas raportit të ESI-t, shtetet anëtare të BE-së, si Gjermania

dhe Austria, kanë zvogëluar dukshëm pranimin e emigrantëve për punë dhe i kanë hapur dyert vetëm për shtetet që janë anëtare të BE-së, sidomos për ato që u pranuan në vitin 2004. Në anën tjetër, ministrat e jashtme të këtyre vendeve evropiane po mundohen se si të krijojnë një zgjidhje të qëndrueshme politike për Kosovën. Përdërisa objektivi i ministrave të brendshme të këtyre vendeve është që ta ndalin migrimin nga vendet e Ballkanit. Këto dy qëllime fundamentalisht të paqëndrueshme dhe në kundërshtim me njëra-tjetrën. Gjithashtu hartuesit e strategjive ekonomike kanë qëndruar dukarqy duke u ndier komod me paratë e dërguara nga emigrantët zemërgjerë shqiptarë të diasporës, të cilët jetën rurale të Kosovës e lanë të notojë për dekada por duke mos promovuar zhvillim serioz.



## Danezëve të interesuar për ambientin në Kosovë

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** — Në një takim të veçantë Ministri Ardian Gjini ka takuar të hënën një delegacion të lartë të Asociacionit Danez për Politika të Jashtme të kryesuar nga Klaus Carsten Pedersen. Delegacioni Danez që është për vizitë në rajon (Prishtinë, Podgorice dhe Beograd) u

interesuar kryesisht për zhvillimet e fundit në Kosovë, zhvillimet politike, posaçërisht për ato që kanë të bëjnë me statusin përfundimtar të Kosovës.

Njëheri të pranishmit u interesuan edhe për gjendjen mjedisore në Kosovë si dhe për punët dhe aktivitetet që po i zhvillojnë

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ministri Gjini i njoftoi të pranishmit me procesin e negociatave si dhe për agjendën politike të Kosovës. Ai theksoi nevojën e njohjes së Pavarësisë së Kosovës si dhe të përkrahjes ndërkombëtare gjatë kësaj kohe të rëndësishme

nëpër të cilën po kalon Kosova. Ministri Gjini falënderoi Qeverinë Daneze për përkrahjen e tyre që i kanë ofruar Kosovës dhe inkurajoi që edhe me tutje Danimarka të ketë angazhim dhe ndikim e saja në proceset që po zhvillohen në Kosovë.

(A. Behrami)

# FUNDI I NJE EPOKE



Gratë mundohen ti gjejnë vetës punë. / FOTO: FERDI LIMANI

### Disa shekuj prapa

Aeroporti i Prishtinës shtrihet vetëm 30 kilometra larg kryeqytetit të Kosovës. Ai ishte ndërtaur si një aeroport ushtarak, në një territor ku vazhdimisht është nën mjegull dhe i rrethuar nga toka aspak e rrafshet përreth. Nuk ishte planifikuar kurrë për një aeroport komercial të një kryeqyteti evropian dhe, si rezultat, dal nga dal, po fundoset në moçal. Megjithatë, Aeroporti i Prishtinës, ashtu siç është, është aeroporti më i ngarkuar me punë në Evropën Lindore. Në vitin 2003 një revistë zvicerane e përshkruan këtë aeroport si më të suksesshmin në Ballkanin Perëndimor, duke cilësuar se për dy vite e ka rritur numrin e udhëtarëve për 75 për qind, ndërsa në vitin 2005 e kapi shifërën prej 1 milion udhëtarësh qarkullim. Prishtina është shndërruar në një destinacion profitabil. Edhe gjatë dimrit kur 14 kompani ajrore ndërkombëtare operojnë fluturime për Prishtinë për çdo ditë. Disa nga këta udhëtarë janë edhe të huaj, pjesëtarë të stafit të UN-it dhe policë që kthehen për të punuar në Kosovë, por pa dyshim numri më i madh i udhëtarëve i përket familjeve shqiptare që jetojnë në Gjermani dhe Zvicër, të cilët kthehen në fshatrat e tyre për disa javë, përndryshe Aeroporti i Prishtinës është një lidhje në mes Kosovës rurale dhe ekonomisë botërore. Migrimi ka qenë një nga tregimet kryesore që e ka karakterizuar shoqërinë kosovare me dekada, ashtu siç tregojnë edhe gjeneratat e vjetra të irlandezëve, grekëve dhe spanjollëve (e njëjta para disa shekujsh kishte ndodhur edhe me gjermanët dhe anglezët). Por, për gjatë shekullit 20,

kryefamiljarët kosovarë mbijetonin dhe përparonin duke i dërguar fëmijët e tyre si punëtorë emigrantë vendit për vite të tëra. Ata, në Evropë, u bënë ndërtime, punëtorë bujqësie, e në disa raste edhe shitnin akullore. Në një të kaluar më të largët destinimi i këtyre emigrantëve ishte drejt Stambollit dhe Selanikut. Më vonë, në epokën socialiste shkonin për në Zagreb dhe Beograd (duke i hapur furat dhe ëmbëltoret e tyre të famshme) dhe në fund, gjatë viteve të '60-ta, rritja e ekonomive evropiane i tërhoqi emigrantët kosovarë. Në fillim emigrantët shqiptarë flinin grumbull në një dhomë në qytetin e Shtutgarit ose të Gjenezës. Kështu ata i ruanin rrogat e tyre për t'ia dërguar familjes. Paratë e dërguara u ndihmonin kryefamiljarëve në Kosovë të blinin një traktor dhe disa lopë të reja, të paguanin për dasma dhe të rrisnin shtëpinë ku jetonte familja. Kështu u bëhej vend pjesëtarëve të gjeneratës së re. Fjalët e një antropologu amerikan, i cili studioi jetën në Kosovë gjatë viteve '80-ta, e përshkruan se "një djalosh sillet i lirë gjithë ditën e lume, përdërsa gjen një tren ku kalon një 30 orësh udhëtim për në Zvicër, për të punuar, gjithçka, çfarëdo pune... dhe me paratë e fituara të blejë bizhuteritë prej ari për nusen të cilën ia kanë gjetur prindërit".

Gjatë viteve të '70-ta shfaqen edhe të mirat socialiste dhe të industrializimit, si alternativë ndaj migrimit. Arsimit fillon të shikohet si një drejtim i ri dhe i sigurt dhe popullariteti i tij jehon edhe në familjet më tradicionale të Kosovës. Vende të reja pune fillojnë të shfaqen në administratën publike dhe në kompani me pronësi publike. Për një dekadë e pak më shumë, kosovarët fshatarë shqiptarë filluan të gjejnë punë në Prishtinë, Prizren dhe Pejë. Femrat shpresonin të gjenin burra që punonin dhe të mbetnin në Kosovë bashkë me ta. Përdërsa të tjerat kishin ambicie të gjejnë punë edhe vetë. Por kjo periudhë nuk zgjati shumë. Krizat e socializmit jugosllav nisën në fillim të viteve të '80-ta, duke e ndalur vrazhdësisht krijimin e vendeve të reja të punës në institucionet publike. Në fund të viteve të '80-ta kësaj gjendje të rëndë i jep vulë regjimi i Millosheviqit, duke iu humbur shpresat kosovarëve për çfarëdo përparimi. Atëherë ikjet jashtë vendit filluan me të shpejtë. Drejt Gjermanisë dhe Zvicrës si vende më të preferuara. Kah mesi i viteve të '90-ta vlerësohej se gjysmëmilion shqiptarësh nga Kosova punonin dhe jetonin



Fuqia e tepërt punëtorë pataqet problem ek

jashtë vendit, që i bie diku 25 për qind e mbarë popullatës.

### Fundi i një epoke

Gjatë fillimit të viteve të '90-ta, kur dhuna dhe represioni eskaluan në Kosovë, kosovarët u shndërruan nga emigrantët punëtorë në emigrantë politikë. Ata të cilët arritën në Gjermani fituan të "drejta tolerante", që ishte më pak se azil politik. Kjo, në njëfarë mënyre, iu mundësoi kosovarëve emigrantë të qëndrojnë në këto vende edhe nëse nuk ishin personalisht të persektuar. Me intervenimin e NATO-së, në vitin 1999, i dha fund kontrollit serb mbi Kosovën. Gjithashtu ky sulm i dha fund edhe tolerimit të shqiptarëve të Kosovës si emigrantë në Evropë. Më shumë se 100 mijë kosovarë u detyruan të kthehen vetëm nga Gjermania. Në të njëjtën kohë, emigrimi legal u kufizua në programe të bashkimit familjar. Papritmas, Kosova, pa dëshirë, filloi të rrimportojë emigrantë të punës. Dhe emigrimi u kthye në të kundërtën. Damari që e mbante ekonominë të gjallë u këput. Për të kuptuar ndikimin e emigrantëve në shoqërinë kosovare është e rëndësishme të dihet numri i tyre jashtë Kosovës. Megjithatë për t'i gjetur këto shifra është një detyrë e vështirë, sepse kosovarët nuk dallohen administrivisht nëpër statistika nga qytetarët e Serbisë dhe të Malit të Zi. Në mars të vitit 1992 Qev-

## Fëmijët po i braktisin shkollat

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** — Komiteti kosovar për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka filluar monitorimin për fëmijët që punojnë, ku do të bëhet identifikimi, tërheqja, përkrahja dhe mbrojtja e tyre nga format e rezikshme të punës. Mustafë Gara, drejtor i Institutit poli-

tik e social në Ministrinë e Punës, është vështirë të përcaktohet numri i fëmijëve që punojnë sepse ata nuk punojnë vazhdimisht. Gara tha se kanë bërë një testim me 480 mijë fëmijë që punojnë dhe ka rezultuar që 13 për qind e tyre kanë lënë shkollën për punë dhe kanë qenë mesatar në mësim, ndërsa 7 për qind e tyre janë

larguar nga shkolla sepse nuk kanë shprehur interesim për të. Nurije Kelmendi, gjatë monitorimit të punës kanë vërejtur se një numër i madh i fëmijëve është i përfshirë në punë, një numër i tyre është i tërhequr në format më të rënda të punës, që është çështje shumë shqetësuese, andaj objektiva e programit është që të kontribuojë në përf-

shirjen e çështjes së punës së fëmijëve në sistemin e qeverisjes. Ky grup punues ka evidencuar format e rënda të punës së fëmijëve, si në rrugë, bujqësi, në depo dhe fusha tjera. Monitorimi mundësohet nga shumë qendra sociale, organizata, shtëpi të shëndetit, policia sektori i hetimeve të dhunës, qendrat e shëndetit mental etj.



momik. / FOTO: ERMAL META

eria e Kosovës në ekzil bëri përpjekjet e para që të vlerësojë numrin e emigrantëve kosovarë jashtë vendit. Të gjithë të regjistruarit ishin 217 mijë. Studiimi i tyre vlerësoi se komuniteti më i madh ishte në Gjermani (82 mijë), Zvicër (72 mijë), Suedi (15 mijë) dhe në Austri (12 mijë). Gjermania dhe Zvicra mbeten vendet më të popullarizuara për kosovarët gjatë viteve të '90-ta. Si rezultat i kësaj politikë për emigrantë në këto dy vende patën një efekt pozitiv për zhvillimet në Kosovë.

Në vitin 1999 rreth 180 mijë shqiptarë nga Kosova e humbën statusin e tyre legal të qëndrimit dhe u detyruan të lëshojnë vendin. Gjashtë vjet më vonë rreth 90 mijë u kthyen në Kosovë të ndihmuar me programe për kthimin vullnetar. Gjithashtu gjatë këtij viti rreth 20 mijë emigrantë u depërtuan nga Gjermania, e të cilët nuk u ndihmuar nga autoritetet. Kjo nënkupton se një pjesë e madhe e shqiptarëve që arritën në Gjermani gjatë viteve të '90-ta u kthyen përsëri në Kosovë.

Sipas të gjitha të dhënave të konsultuara nga ESI shumica e emigrantëve kosovarë ishin të pamartuar, të rinj dhe të dërguar nga familjet e tyre për të punuar. Shumica prej tyre dërgonin para në shtëpi, megjithatë një pjesë e tyre filloi të martohet duke i ndaluar ndihmat për familjet në Kosovë. Pasojat e parave të dër-

guara në Kosovë ndikuan në tri drejtime:

1. Numri total i kosovarëve që jetonte në diasporë është

zvogëluar;

2. Diaspora nuk ripërthitet më me të ardhur të rinj, e të pamartuar;

3. Kosovarët që mbeten jashtë, me veti i kanë edhe familjet, gjë që vështirëson kthimin e tyre në Kosovë.

Përfundimi i epokës së emigrimit masiv është reflektim i zhvillimeve pozitive dhe fundit të represionit nga Serbia në Kosovë, edhe pse kjo nuk ka reflektuar ndonjë ndryshim për kushtet ekonomike. Thjeshtë u mbyll një pasuri e sigurt.

### Paratë e emigrantëve: Mit apo realitet

Në përgjithësi besohet se ekonomia e Kosovës mbahet nga paratë e dërguara prej diasporës zemërgjerë. Diaspora dhe pasuria është një nga mitet më të fuqishme të Kosovës sot. Kjo besohet edhe tek të huajt që jetojnë në Kosovë. Megjithatë, këta emigrantë ishin ata që financuan sistemin paralel të edukimit dhe shëndetësisë. Ishte gjithashtu diaspora që financonte UÇK-në dhe pagoi për një pjesë të madhe të rindërtimeve – pasluftës. Megjithatë, paratë e dërguara ngadalë fillojnë të shënojnë një rënie deri në vitin 2004, duke shënuar ngritje në vitin 2005 dhe 2006. Fondi Monetar Ndërkombëtar bëri përpjekjet e para që të numërojë këto para në vitin 2001, që vlerësoi se të hyrat ishin rreth 610 milionë. Në vitin 2003, Ministria e Financave vlerësoi se nga pensionet e huaja dhe paratë e dërguara nga emigrantët kanë hyrë rreth 720 milionë euro. Gjithashtu po në këtë vit, raporti vjetor i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës thotë se të hyrat vetëm nga paratë e dërguara nga jashtë arrijnë në

### VLERËSIMET E FMN-SË PËR TË HYRAT NGA DIASPORA

2001 – 317 milionë

2002 – 341 milionë

2003 – 341 milionë

2004 – 339 milionë

2005 – 375 milionë

2006 – 347 milionë

Sipas disa të dhënave, FMN e ka ndërruar formën e vlerësimit të vjetër, e cila nuk përputhet me të dhënat e Bankës Botërore.

A mund të ndodhë që paratë e dërguara mund të reduktohen kaq shpejt dhe për një periudhë kaq të shkurtër? Një shpjegim mund të gjendet me kthimin e më shumë se 100 mijë kosovarëve nga Gjermania, e të cilët nuk dërgojnë më para, të mirat materiale, vetura etj., drejt kryefamiljarëve të tyre.

Duket reale se paratë që dikur e mbajtën Kosovën të gjallë sot janë në shumë më të vogël dhe se besimi i masës së gjerë se diaspora është kuleta e pashtershme, pothuajse në realitet ajo më nuk ekziston.

568 milionë euro. Nga viti 2004 Fondi Monetar Ndërkombëtar, pas disa hulumtimeve, përgjysmon shifrat e raportuara dhe del me një vlerësim të ri.

(Nesër mund të lexoni vazhdimin e dytë. Ekspertët e ESI-i kanë shndërruar në laborator hulumtimi dy fshatra të Kosovës. Njëri është fshati i lindjes së presidentit të ndjerë, Ibrahim Rugovës)



Evropa e mbyllë derën për emigrantët kosovarë. / FOTO: FERDI LIMANI

“Kosova nuk mundet të shpëtojë as në përmbljedhjet më optimiste, e as kur arrihet të përmbushen planet e parapara për zhvillim, për shkak se nuk mund t'i shpëtojë rritjes rapide të forcës punëtore. Ndalja e emigrimit të kosovarëve do të thotë çrregullim social dhe vdekje ekonomike për Kosovën.”

Banka Botërore ka raportuar më 1979